

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.04.04.2023*

**04.04.2023
Ora 16:06**

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për caktimin e vendndodhjes së disa qendrave të votimit në ndërtesa private, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

PJESËMARRJA :

- **Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve: Z. Ilirjan Celibashi**
- **Stafi KQZ: Z. Y.Merkaj, Znj. M. Koja,
Znj. P. Doçaj, Z. E. Meta**
- **Parti Politike: PDIU**
- **Të tjerë: KRIIK**

Z. I. Celibashi: Mirëdita! Në seancën e sotme kemi në rendin e ditës projektvendimin që lidhet me caktimin e vendndodhjes së disa qendrave të votimit në ndërtesa private, për zgjedhjet e datës 14 maj.

Shqyrtimin e kërkesës së subjektit zgjedhor “Partia Socialiste” për miratimin e listave shumemërore. Për disa apo tër të gjitha bashkitë këto?! Po për 11 bashki.

Shqyrtimin e kërkesës Partisë “Lëvizja e Legalitetit” për miratimin e listave shumemërore për disa bashki.

Po kështu projektvendimin që lidhet me shqyrtimin e kërkesës së subjektit zgjedhor Partia “Drejtësi, Integritim dhe Unitet”për miratimin e listave shumemërore për anëtarë të këshillit të disa bashkive.

Shqyrtimin e kërkesës për miratimin e listave shumemërore të këshillit bashkiak, Bashkia Tiranë, të subjektit zgjedhor “Partia Konservatore”. Këto janë! Pastaj në mbledhjen e orës 18:00 do të vazhdojmë me shqyrtimin e kërkesave të tjera. Po,

***Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI***



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.04.04.2023*

fillojmë me pikën e parë për caktimin e vendndodhjes së disa qendrave të votimit në ndërtesa private.

Z. Y. Merkaj: Faleminderit. Referuar nenit 93, paragrafët 2 dhe 3 të Kodit Zgjedhor KQZ-ja mund të caktojë qendra votimi në ndërtesa private kur nuk ka mundësi objektive për të përdorur një ndërtesë publike në zonën e qendrës së votimit ose në një zonë qendre votimi fqinje. Kryetari i njësisë së vetqeverisjes vendore, i propozon KQZ-së caktimin e qendrës së votimit në ndërtesë private në pronësi të personave fizikë ose juridik, duke paraqitur planimetrinë përkatëse ose fotografi të ambientit, një përshkrim për lehtësitë që ofron objekti për zhvillimin normal të zgjedhjeve, si dhe të dhëna të tjera për efekt të plotësimit të kriterëve të përcaktuara në kuadrin ligjor. Në këtë projektvendim kemi administruar propozimet nga 3 (tre) kryetarë të bashkive (bashkia Durrës, bashkia Lezhë, bashkia Shijak) për caktimin e vendndodhjeve të 44 qendrave të votimit në ndërtesa private. Nga shqyrtimi i të dhënave në dokumentacionin e administruar, rezulton se propozimet përmbushin kriteret e përcaktuara në Udhëzimin nr.1, të vitit 2020 të Komisionit Rregullator “Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjes së hartës së njësisë së vetqeverisjes vendore për zgjedhjet”. Nga propozimi ose nga projektvendimi që kemi nisur dje për partitë politike për njohje janë shtuar edhe 3 (tre) qendra votimi në bashkinë Lezhë pasi na ka ardhur propozimi nga kryetari me vonesë si dhe 12 (dymbëdhjetë) qendra votimi për bashkinë Durrës. Propozojmë që ti shtohen listës së këtyre objekteve edhe keto propozimet e Kryetarit të Bashkisë Lezhë dhe Bashkisë Durrës. Faleminderit.

Z. I. Celibashi: Ja keni përcjellur edhe partive?

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.04.04.2023*

Z. Y. Merhaj: Jo këto të 3 (tre) nuk ja kemi përcjellur, do t'ia përcjellim. Megjithatë ne mendojmë që i plotësojnë kriteret dhe duke qenë se është edhe afati i fundit sot...

Z. I. Celibashi: Dakord, i miratojmë por ndërkohë do të duhet t'ju bëjmë me dije përfaqësuesve të partive politike nëse ka ndonjë konsideratë për këtë vendimarrje më tej.

Vendim nr. 255

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.04.04.2023*

04.04.2023
Ora 16:10

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqytimin e kërkesës për miratimin e listave shumemërore të subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

PJESËMARRJA :

- Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve: **Z. Ilirjan Celibashi**
- Stafi KQZ: **Z. Y.Merkaj, Znj. M. Koja,
Znj. P. Doçaj, Z. E. Meta**
- Parti Politike: **PDIU**
- Të tjerë: **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Dakord, atëhere kalojmë tek pika tjetër e rendit të ditës që ka të bëjë me miratimin e listave shumemërore të subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” për disa bashki.

Z. Y. Merkaj: Po! “Partia Socialiste e Shqipërisë” është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet vendore të datës 14 maj 2023 dhe ka paraqitur në KQZ dokumentacionin për miratimin e listave shumemërore. Në mbështetje të nenit 73 të kodit zgjedhor administrata e KQZ-së ka verifikuar listat shumemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak për bashkitë: Berat, Durrës, Elbasan, Fier, Lezhë, Lushnje, Shkodër, Tiranë, Vlorë, Kamëz dhe Korçë të “Partise Socialiste” dhe rezulton se është në përputhje me kriteret dhe kërkesat e parashikuara në nenin 67 dhe 72 të Kodit Zgjedhor. Kandidatët për anëtar të Këshillit Bashkiak të këtyre bashkive kanë depozituar formularët e vetdeklarimit

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.04.04.2023*

në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Nga verifikimi paraprak i këtyre formularëve konstatohet se kandidatët nuk kanë deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin numër 138 të vitit 2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. Ku në përgjigje të kërkesës tonë Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ende nuk ka kthyer përgjigje ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka dërguar verifikimin e të dhënave për kandidatët për anëtarë të Këshillave Bashkiak të subjektit zgjedhor “Partia Socialiste” të bashkive të mësipërme dhe konstatuam se nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin e kandidatëve në zgjedhjet vendore të datës 14 maj 2023. Pas verifikimeve përkatëse të kërkesave dhe dokumentacionit në tërësi të listave shumëmemërore konstatohet se dokumentacioni është në përputhje me nenes 67, 72 dhe 78 të Kodit Zgjedhor dhe për këtë arsye i propozojmë Komisionerit miratimin e listave shumëmemërore të kandidatëve për anëtar të Këshillit Bashkiak në bashkitë Berat, Durrës, Elbasan, Fier, Lezhë, Lushnje, Shkodër, Tiranë, Vlorë, Kamëz dhe Korçë të subjektit politik “Partia Socialiste e Shqipërisë”. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Mirë, atëhere miratojmë listat shumëmemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak për bashkitë: Berat, Durrës, Elbasan, Fier, Lezhë, Lushnje, Shkodër, Tiranë, Vlorë, Kamëz dhe Korçë për subjektin zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.

Vendim nr. 256

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.04.04.2023*

04.04.2023
Ora 16:12

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesës për miratimin e listave shumemërore të subjektit zgjedhor “Partia Lëvizja e Legalitetit”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ:**
- **Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve: Z. Ilirjan Celibashi**
- **Stafi KQZ: Z. Y.Merkaj, Znj. M. Koja,
Znj. P. Doçaj, Z. E. Meta**
- **Parti Politike: PDIU**
- **Të tjerë: KRIIK**

Z. I. Celibashi: Kalojmë tek pika tjetër.

Z. Y. Merkaj: Po! “Partia Lëvizja e Legalitetit” është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet vendore të datës 14 maj 2023 dhe ka paraqitur për miratim listat shumemërore. Administrata e KQZ-së ka verifikuar listat shumemërore të kandidatëve për anëtar të këshillit bashkiak për bashkitë: Berat, Durrës, Elbasan, Fier, Lezhë, Lushnje, Shkodër, Tiranë, Vlorë, Kamëz dhe Korçë të “Partia Lëvizja e Legalitetit”. Kandidatët për anëtarë të këshillit bashkiak për këto bashki kanë depozituar formularët e vetdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Nga verifikimi paraprak i këtyre formularëve konstatohet se kandidatër nuk kanë deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin numër 138 të vitit 2015. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ende nuk ka kthyer

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.04.04.2023*

përgjigje për verifikimin e të dhënave të kandidatëve për anëtarë të Këshillave Bashkiak ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka dërguar verifikimin e të dhënave për kandidatët për anëtarë të këshillave bashkiak të subjektit zgjedhor “Partia Lëvizja e Legalitetit” për bashkitë e mësipërme dhe konstatoam se nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin e tyre në zgjedhjet vendore të datës 14 maj 2023. Për këto arsye duke parë se dokumentacioni i paraqitur për miratimin e listave shumemërore është në përputhje me nenes 67, 72 dhe 78 të Kodit Zgjedhor i propozojmë komisionerit miratimin e listave shumemërore të kësaj partie për bashkitë e mësipërme. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Atëhere miratojmë listat shumemërore të kandidatëve për anëtar të Këshillit Bashkiak për bashkitë Berat, Durrës, Elbasan, Fier, Lezhë, Lushnje, Shkodër, Tiranë, Vlorë, Kamëz dhe Korçë për subjektin zgjedhor “Partia Lëvizja e Legalitetit”.

Vendim nr. 257

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.04.04.2023*

04.04.2023

Ora 16:14

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqytimin e kërkesës për miratimin e listës shumemërore të këshillit bashkiak, Bashkia Tiranë, të subjektit zgjedhor “Drejtësi, Integrim dhe Unitet”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

PJESËMARRJA :

- Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve: **Z. Ilirjan Celibashi**
- Staf i KQZ: **Z. Y.Merkaj, Znj. M. Koja,
Znj. P. Doçaj, Z. E. Meta**
- Partit Politike: **PDIU**
- Të tjerë: **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Kalojmë tek pika tjetër.

Z. Y. Merkaj: Po! “Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet” është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet vendore të datës 14 maj 2023 dhe ka paraqitur në KQZ dokumentacionin për miratimin e listave shumemërore. Administrata e KQZ-së ka verifikuar listat shumemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak për Bashkinë Tiranë të “Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet” dhe rezulton se është në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenin 67 dhe 72 të Kodit Zgjedhor. Kandidatët për anëtar të Këshillit Bashkiak për Bashkinë Tiranë të subjektit “Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet” kanë depozituar formularët e vetdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Nga verifikimi paraprak i të cilëve konstatohet se kandidatët nuk kanë deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për

**Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI**




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.04.04.2023*

ndalime në ligjin numër 138 të vitit 2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. Ku në përgjigje të kërkesës tonë Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ende nuk ka kthyer përgjigje ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka dërguar verifikimin e të dhënave për kandidatët për anëtarë të Këshillit Bashkiak, Bashkia Tirane të subjektit zgjedhor “Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet” dhe konstatohet se nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin e kandidatëve në zgjedhjet vendore të datës 14 maj 2023. Për këto arsye duke parë se dokumentacioni i paraqitur për miratimin e listave shumemërore është në përputhje me nenet 67, 72 dhe 78 të Kodit Zgjedhor i propozojmë komisionerit miratimin e listave shumemërore të kësaj partie për anëtar të Këshillit Bashkiak, bashkia Tiranë. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Atëhere miratojmë listat shumemërore të kandidatëve për anëtar të Këshillit Bashkiak për Bashkinë Tiranë për subjektin zgjedhor “Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet”.

Vendim nr. 258

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.04.04.2023*

04.04.2023

Ora 16:15

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqytimin e kërkesës për miratimin e listës shumemërore të këshillit bashkiak, Bashkia Tiranë, të subjektit zgjedhor “Partia Konservatore”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

PJESËMARRJA :

- Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve: **Z. Ilirjan Celibashi**
- Stafi KQZ: **Z. Y.Merkaj, Znj. M. Koja,
Znj. P. Doçaj, Z. E. Meta**
- Parti Politike: **PDIU**
- Të tjerë: **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Kalojmë tek pika e fundit.

Z. Y. Merkaj: “Partia Konservatore” është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet vendore të datës 14 maj 2023 si dhe ka paraqitur dokumentacionin për miratimin e listave shumemërore. Dhe duke qenë se është parti që nuk ka mandat në Këshillin e Bashkisë ka dorëzuar edhe listat mbështetëse për nënshkrimet. Të cilat pasi janë verifikuar 5% e listave konstatohet se është në përputhje me nenin 73 dhe 78 të Kodit Zgjedhor. Administrata e KQZ-së ka verifikuar listat shumemërore të kandidatëve për anëtar të Këshillit Bashkiak për Bashkinë Tiranë të kësaj partie dhe rezulton se është në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenin 67 dhe 72 të Kodit Zgjedhor. Gjithashtu kandidatët për anëtar të Këshillit Bashkiak për Bashkia Tiranë të këtij subjekti kanë depozituar formularët e vetdeklarimit. Nga verifikimi paraprak i të cilëve konstatohet se kandidatër nuk kanë deklaruar asnjë

**Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.04.04.2023*

të dhënë që ka të bëj me parashikimet për ndalime në ligjin numër 138 të vitit 2015. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ende nuk ka kthyer përgjigje ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka dërguar verifikimin e të dhënave për kandidatët për anëtarë të Këshillit Bashkiak, Bashkia Tirane të subjektit zgjedhor “Partia Konservatore” ku konstatohet se nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin e kandidatëve në zgjedhjet vendore të datës 14 maj 2023. Për këto arsye duke parë se dokumentacioni i paraqitur për miratimin e listave shumemërore është në përputhje me nenet 67, 72 dhe 78 të Kodit Zgjedhor i propozojmë Komisionerit miratimin e listave shumemërore të kësaj partie për anëtar të Këshillit Bashkiak, bashkia Tiranë të “Partia Konservatore”. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Atëhere miratojmë listat shumemërore të kandidatëve për anëtar të Këshillit Bashkiak për Bashkinë Tiranë për subjektin zgjedhor “Partia Konservatore”. Tjetër, nuk kemi! Mirë! Për bashkitë e tjera dhe subjektet e tjera do të vazhdojmë nga ora 18:00.

Vendim nr. 259

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*

